



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. _____ prot.

Tiranë, më 22.6.2022

Lënda: Bisedime përfundimtare të Komisionerit Publik në çështjen ankim kundër vendimit nr. 342, datë 2.2.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit znj. Elbana Lluri

Baza ligjore: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”

Drejtuar: Kolegjit të Posaçëm të Apelit

Të nderuar anëtarë të trupit gjykues,

Në përfundim të këtij shqyrtimi gjyqësor, në referencë të nenit 302 dhe 303 të Kodit të Procedurës Civile, në zbatim edhe të Rekomandimit të ONM-së, si dhe parashtrimeve me shkrim të paraqitura në seancat gjyqësore të datave 28.3.2022, 4.5.2022 dhe 9.6.2022, të zhvilluara në kuadër të këtij gjykimi, Komisioneri Publik vlerëson si në vijim:

Kolegji, mbi bazën e shkaqeve të ankimit, si dhe Opinionit të paraqitur të ONM-së për bashkimin e çështjeve objekt ankimi, të subjektit të rivlerësimit dhe ish-bashkëshortit të saj, vendosi të ndërmarrë disa veprime procedurale, si lejimin e çeljes së hetimit gjyqësor, marrjen në cilësinë e provës të akteve përkatëse, si dhe përgatitjen e një analize paraprake ekonomike-financiare për subjektin e rivlerësimit, znj. Elbana Lluri, personat e lidhur dhe personat e tjerë të lidhur me të¹.

Nisur nga përmbajtja e analizës paraprake financiare të kryer nga Kolegji, bazuar në shkaqet e ankimit, prapësimet e subjektit dhe provat e administruara nga Kolegji gjatë hetimit gjyqësor, referuar kërkimit të këtyre bisedimeve përfundimtare të Komisionerit Publik, për ndryshimin e vendimit të Komisionit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, konstaton si më poshtë:

¹ Analiza paraprake është njoftuar nga Kolegji i Posaçëm i Apelit, më datë 21.4.2022, me anë të shkresës përcjellëse me nr. 19/21 regj. (JR).

1. *Pasuria "Apartament banimi" me sip. 126,5 m², në Vlorë, në shumën 55.452 euro²*

1.1 Lidhur me verifikimin dhe justifikimin e burimeve të ligjshme të deklaruara si të përdorura për blerjen e kësaj pasurie, konkretisht kursimeve *cash* të subjektit dhe personit të lidhur me të, në cilësinë e bashkëpronarëve, sipas përshkrimit të bërë në deklaratat e tyre të pasurisë për efekt të ligjit nr. 84/2016, Kolegji, në analizën paraprake financiare të kryer bazuar në pretendimet e Komisionerit Publik, referuar kursimeve të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e saj të parë, DV-2004, ka evidentuar se subjekti i rivlerësimit rezulton me situatë financiare negative në vlerën prej – **3.534.757 lekë³**, për krijimin e kursimeve *cash* të deklaruar në deklaratën para fillimit të detyrës në vitin 2004, në shumën 5.000.000 lekë.

1.2 Përveç sa më sipër, pas rivlerësimit edhe të kursimeve në *cash* të deklaruara në vitet në vijim deri në momentin e krijimit të kësaj pasurie, bazuar në shkaqet e ankimit, Kolegji ka evidentuar se në vitin 2016, subjekti dhe personi i lidhur kanë pasur në dispozicion si kursime *cash* vetëm shumën 1.665.243 lekë, për të përdorur për blerjen e pasurisë *Apartament banimi*.

1.3 Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet ndaj analizës paraprake financiare në seancën gjyqësore të datës 9.6.2022, lidhur me këto elemente të analizës, ka pretenduar:

(i) Për sa i përket shumës së deklaruar të kursyer në deklarimin e saj të parë, në vitin 2004, në vlerën 5.000.000 lekë, duhet të përfshihet në analizën e kryer edhe shuma 2.000.000 lekë, si vlera e dhurimit të marrë nga motra, pasi kjo shumë nuk rezulton të ketë qenë shkak ankimi, si dhe përfshirjen në analizë të një vlerë kumulative të shumës 35.000 lekë/muaj, për periudhën 1997-2004, deklaruar si e ardhur e dhënë nga e motra. Lidhur me këto pretendime, subjekti ka paraqitur një skemë analitike financiare për periudhën deri në vitin 2004, sipas disa varianteve të ndryshme, duke përfshirë dhe të ardhurat e prindërve nga pensionet dhe ndihma e dhënë nga motra, ***.***.

(ii) Rishikimin e llogaritjeve të kryera nga Kolegji lidhur me kursimet *cash* të subjektit në deklaratat periodike vjetore 2006-2016, duke pretenduar në mënyrë alternative (ii.i) kursime *cash* për vitin 2006, në shumën 810.000 lekë (jo 450.000 lekë, sa llogaritur nga Kolegji); 450.000 lekë në vitin 2007 dhe 225.000 lekë në vitin 2008 apo (ii.ii) një version tjetër të kursimeve në shumat 675.000 lekë në vitin 2006, 375.000 lekë në vitin 2007 dhe 220.000 lekë në vitin 2008, si dhe pakësimin e kursimeve *cash* të vitit 2012, në masën – 676.000 lekë, të saj dhe personit të lidhur, për pagesën e automjetit Citroën.

(iii) Rishikimin e përlllogaritjeve të shpenzimeve të udhëtimit sipas llogaritjeve të Komisionit.

1.4 *Komisioneri Publik*, në vlerësim të analizës paraprake financiare të kryer nga Kolegji, bazuar në shkaqet e ankimit dhe prapësimet e subjektit, në seancën e datës 9.6.2022, lidhur me këtë shkak ankimi, vlerëson se:

1.4.1 Lidhur me kursimet e deklaruara nga subjekti në DV-2004, në shumën 5.000.000 lekë, për sa i përket pretendimit të subjektit, pretendim ky i parashtruar për herë të parë gjatë prapësimeve

² Kontratë nr. *** rep., nr. *** kol., datë **9.2016.

³ Kjo diferencë do të thellohej nëse merret në konsideratë reduktimi i të ardhurës nga Universiteti "****", në masën 78.000 lekë, referuar tabelës së paraqitur nga vetë subjekti, në prapësimet e paraqitura në seancën e datës 9.6.2022.

për analizën financiare në seancën e datës 9.6.2022, se shuma 2.000.000 lekë nuk është pjesë e ankimit, Komisioneri Publik e gjen të pabazuar, pasi shkaku i ankimit ka qenë *rikryerja e analizës financiare mbi vlerësimin e mundësive të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, për të mbuluar me burime të ligjshme nga të ardhura të ligjshme, pasuritë e deklaruara në D-Vett., si dhe ato të rezultuara gjatë hetimit administrativ*. Shuma 2.000.000 lekë është pjesë përbërëse e shumës së 5.000.000 lekë, deklaruar nga subjekti si një nga burimet e krijimit të pasurisë “Apartament banimi” me sip. 126,5 m², Vlorë.

1.4.2 Lidhur me këto kursime, nga analizimi i akteve në dosje rezulton se:

1.4.2.1 Në DV-2004, nga ana e subjektit janë deklaruar: të holla *cash* të ruajtura në shtëpi, vlera 5.000.000 lekë, burimi: Nga kursimet e mia dhe të familjes, dhuratë nga motra.

1.4.2.2 Në D-Vett., nga ana e subjektit janë deklaruar: Të ardhura në vlerën 5.000.000 lekë, burimi: Të ardhura neto të fituara nga paga si studente e Shkollës Magjistraturës (*e kursyer e gjitha*), punësimi si pedagogë në Universitetin “****” (*që nga themelimi i tij në vitin 2003, pa kontratë deri vitin 2004*), me pagë mujore 25.000 lekë, punësimi te biznesi i ndërtimit të motrës, ****.*** (*që nga viti IV shkollës së mesme deri vitin II të shkollës së Magjistraturës, pa pasur kontratë pune, për shkak të punësimit në një biznes familjar*), me pagë mujore 30.000 - 40.000 lekë, të ardhura të dhuruara nga motra, ****.***, për shkak të mbarimit shkëlqyer të Shkollës së Magjistraturës. Subjekti ka deklaruar se gjatë kësaj kohe, të gjitha shpenzimet e saj mbulohehin me të ardhurat nga bursa si studente pranë Fakultetit të Drejtësisë dhe nga prindërit, me të cilët banonte dhe motra e saj, znj. ****.***.

1.4.2.3 Në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI, datë **.1.2015, mbi burimin e shumës 5.000.000 lekë, kursime në vitin 2004, është deklaruar sikurse në D-Vett.

1.4.2.4 Gjatë hetimit administrativ të Komisionit, në përgjigje të Pyetësorit nr. 2, subjekti, pasi ka parashtruar edhe njëherë sa ka deklaruar në D-Vett., ka shtuar se: [...] *Njëkohësisht me mbarimin e vitit të dytë të Shkollës së Magjistraturës, me rezultate shumë të larta, motra ime dhe bashkëshorti i saj me kanë dhuruar një shumë prej 2.000.000 lekë, pa kontratë, shumë e cila disponohej cash prej meje së bashku me kursimet e sipërcituara në vitin 2004, kur edhe kam bërë deklarin e parë vjetor të të ardhurave, që kam disponuar në formën e kursimeve deri në atë datë. Gjatë gjithë periudhës së sipërcituar, shpenzimet e mia për jetesë janë përballuar nga të ardhurat e familjarëve të mi, e për sa më sipër, shumat e sipërcituara janë kursime të miat ndër vite, të përfituara përpara se sa unë të filloja ushtrimin e detyrës si gjyqtare në Gjykatën e Shkollës së Parë, Tiranë [...].*

1.4.2.5 Po gjatë hetimit administrativ të kryer nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit, në lidhje me të ardhurat e përfituara nga motra e saj, ka paraqitur dy deklarata noteriale të ndryshme: (i) Deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë **.6.2018, ku shtetasit ****. dhe ****.*** deklarojnë se subjekti i rivlerësimit: [...] *ka qenë e punësuar pranë biznesit të tyre të ndërtimit dhe qiradhënies, me pagë mujore 35.000 lekë... Me znj. Lluri nuk kemi pasur kontratë pune, për shkak se ishte e punësuar në biznes familjar. Për shkak të mbarimit me rezultate të shkëlqyera të Shkollës së Magjistraturës, si dhe për të ndihmuar daljen e saj në jetë, i kemi dhuruar një sasi të ardhurash, në shumën 2.000.000 lekë, pa kontratë, për shkak të marrëdhënies së posaçme midis nesh [...].* (ii)

Deklaratë noteriale nr. *** rep. nr.*** kol., datë **.12.2020, ku shtetasit ***. dhe ***.*** kanë deklaruar: [...] *se gjatë periudhës 1997-2004 i kanë dhënë subjektit të rivlerësimit një shpërblim simbolik, në masën 35.000 lekë, për ndihmën që ajo ka dhënë si në mbajtjen e fëmijëve të vegjël, ashtu dhe në mbledhjen e qirave të pasurive të paluajtshme... dhe për çdo nevojë tjetër familjare, për të cilën ofrohej për të na ndihmuar, por në asnjë rast nuk ka qenë e punësuar pranë shoqërisë që ne kemi në pronësi [...].*

1.4.2.6 Për sa më lart, Komisioneri Publik vlerëson se subjekti i rivlerësimit, edhe gjatë shqyrtimit në Kolegj, nuk paraqiti ndonjë provë apo vërtetoi situatë të ndryshme nga ato të konstatuara në ankimin e datës 14.4.2021, lidhur me shumën 5.000.000 lekë, e deklaruar të kursyer dhe të poseduar në *cash*, në vitin 2004.

1.4.2.7 Nënvizojmë po ashtu, se lidhur me burimin e krijimit, vlerën e tyre dhe shtrirjen ndër vite të të ardhurave të pretenduara të përfituara nga motra e subjektit, në deklaratat në deklaratat vjetore të vetë subjektit, në D-Vett., në përgjigjet e dhëna gjatë hetimit administrativ, si dhe nisur nga përmbajtja e deklaratave noteriale të paraqitura prej saj, konstatohen se ato përmbajnë të dhëna kontradiktore, që e pamundësojnë edhe më tej kontrollin e këtij burimi.

1.4.2.8 Për rrjedhojë, lidhur me këtë zë, kursime *cash* të deklaruara në DV-2004, Komisioneri Publik mbështet përfundimet e analizës së kryer nga Kolegji mbi pamjaftueshmërinë financiare të konstatuar, me një vlerë negativiteti prej **-3.534.757 lekë**, vlerë kjo që reflektohet në mungesën e burimeve financiare në vitin 2016, për blerjen e apartamentit në qytetin e Vlorës, në bashkëpronësi me personin e lidhur.

1.4.3 Lidhur me pretendimet e subjektit mbi rishikimin e kursimeve në *cash* të viteve 2006, 2007, 2008 dhe 2012⁴, Komisioneri Publik vlerëson se për pretendimin e subjektit mbi kursimet *cash* të vitit 2006, në shumën 810.000 lekë, nga analiza financiare e këtij viti, rezulton pamjaftueshmëri e burimeve të ligjshme të subjektit, për të mbuluar shpenzimet dhe kursimet e vitit, për një diferencë negative prej rreth **-336.000 lekë**. Ndërkohë, referuar pretendimeve të subjektit për vitet 2007, 2008 dhe 2012, Komisioneri Publik i gjen ato të mbështetura në deklaratat periodike vjetore të saj.

1.5 Për sa i përket burimit të deklaruar: "*Kursime të personit të lidhur*", trajtuar nga Komisioneri Publik në prg. 29.2.1 të ankimit⁵, vetë subjekti, në seancën gjyqësore të datës 9.6.2022, gjatë trajtimit të burimeve të ligjshme, për krijimin e pasurisë *Apartament banimi* në Tiranë, blerë në vitin 2012, ka parashtuar se: [...] *nga përlllogaritjet e kryera rezulton se, përpara fillimit të detyrës, ish-bashkëshorti ka pasur mundësi të kursejë me të ardhura të tatuara shumën 1.218.204 lekë [...].*

1.5.1 Rezulton se këto kursime të personit të lidhur, së bashku me ndryshimet e viteve në vijim, janë përdorur për pagesën e pasurisë *Apartament banimi* në Tiranë, në vitin 2011.

⁴ Referohuni prapësimeve të subjektit, dorëzuar në seancën e datës 9.6.2022.

⁵ [...] *Për sa më sipër, Komisioneri Publik vlerëson se, në gjendjen që janë, aktet e pretenduara nga subjekti i rivlerësimit, për të provuar burimin e ligjshëm të shumës së kursimeve të deklaruara nga z. ***.***, deklaratat noteriale për marrëdhëniet e punësimit të tij, duket se nuk provojnë të kundërtën e rezultateve të hetimit të Komisionit, sa kohë nuk provohet pagesa e detyrimeve tatimore, referuar nenit D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës [...].*

1.5.2 Ndërkohë, në trajtimin e bërë po nga vetë subjekti⁶, në të njëjtën seancë gjyqësore, ajo ka mbartur si kursime *cash* të personit të lidhur nga viti 2003, shumën e pretenduar 1.218.204 lekë, por nuk ka reflektuar pakësimin e shumës prej 1.500.000 lekë, deklaruar si e përdorur në vitin 2011, për pagesën e pasurisë *Apartament banimi* në Tiranë⁷.

1.5.2.1 Për rrjedhojë, lidhur me këtë zë të burimit të krijimit të pasurisë, “*Kursime të personit të lidhur*”, të deklaruara në DV-2003, Komisioneri Publik mbështet përfundimet e analizës së kryer nga Kolegji mbi pamjaftueshmërinë financiare të konstatuar me një vlerë negativiteti prej – **1.281.796 lekë**, vlerë kjo që reflektohet në mungesën e burimeve financiare në vitin 2016, për blerjen e apartamentit në qytetin e Vlorës, në bashkëpronësi me personin e lidhur.

1.5.3 Lidhur me pretendimet e subjektit mbi kursimet e personit të lidhur për vitet 2006-2007, në konsideratë të llogaritjes së kursimeve *cash* të vitit 2006, në vlerën e pretenduar prej 600.000 lekë, nga analiza financiare për personin e lidhur, për këtë vit, rezulton pamjaftueshmëri financiare e mbulimit të shpenzimeve dhe kursimeve me burime të ligjshme, në shumën rreth –**99.000 lekë**.

1.6 Nisur sa më sipër arsyetuar, Komisioneri Publik vlerëson se për vitin 2016, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të nuk mbulojnë me burime të ligjshme shpenzimet dhe investimet, përfshirë këtu edhe blerjen e pasurisë *Apartament banimi* në Vlorë, për një diferencë negative në total prej –**5.432.452 lekë**.

1.7 Në përfundim për këtë pasuri, rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të ndodhen në kushtet e deklarimit të pasaktë dhe të pamjaftueshëm të pasurisë, referuar nenit D, të aneksit të Kushtetutës, nenit 33, pika 5, germa “b”, dhe nenit 61, pika 3, të ligjit nr. 84/2016.

2. Verifikimi i diferencave negative për vitet 2012 dhe 2016 dhe çështje të tjera të konstatuara gjatë hetimit administrativ, mbi nevojën e rivlerësimit të llogaritjes së shpenzimeve të udhëtimit të subjektit dhe personave të lidhur me të

2.1 Kolegjit, nga analiza paraprake financiare e kryer, bazuar në shkaqet e ankimit, shpjegimet e subjektit gjatë hetimit administrativ, jurisprudencën e deritanishme mbi shpenzimet e udhëtimit dhe të dhënat nga sistemi TIMS, i ka rezultuar se shpenzimet e udhëtimit për vitin 2012 janë në shumën 246.209 lekë (nga 96.300 lekë, të llogaritur nga Komisioni) dhe shpenzimet e udhëtimit për vitin 2016 janë në shumën 489.746 lekë (nga 382.473 lekë, llogaritur më parë nga Komisioni).

2.2 Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e saj në seancën e datës 9.6.2022, lidhur me këtë shkak ankimi, ka pretenduar rishikimin e përlllogaritjeve të shpenzimeve të udhëtimit sipas llogaritjeve të Komisionit, duke mos paraqitur asnjë provë/akt të ri lidhur me këtë pretendim.

2.3 Komisioneri Publik, për sa më sipër, mbështet analizën e kryer nga Kolegji mbi shpenzimet e udhëtimit të subjektit të rivlerësimit. Nga ana tjetër vlerësohet se, pas reflektimeve në analizën financiare të vitit 2012, të pretendimeve të subjektit mbi pakësimin e kursimeve *cash*, për pagesën e këstit të automjetit Citroën, me targë: ***, rezultati financiar i vitit do të ndryshonte, por pakësimi

⁶ F. 30 e prapësimeve, të paraqitura në seancën e datës 9.6.2022.

⁷ Kontratë nr. *** rep., nr. *** kol., datë **.10.2012.

i kursimeve *cash* do të reflektohej në kursimet e akumuluar, të deklaruara të përdorura për pasurinë *Apartament në Vlorë*, trajtuar më sipër.

3. Pasuria “Apartament banimi” me sip. 125 m², në Tiranë, në shumën 6.500.000 lekë⁸

3.1 Për shkakun e ankimit *mbi verifikimin e mundësisë financiare të personit të lidhur, për krijimin me burime të ligjshme të shumës prej 1.500.000 lekë*, paguar për pjesën e tij takuese të pasurisë në bashkëpronësi me subjektin, konkretisht mbi: (i) vlerësimin e kursimeve vjetore në *cash*, ndër vite, të personit të lidhur; (ii) vlerësimin e ligjshmërisë së të ardhurave të personit të lidhur nga pagesa si ekspert ligjor pranë përfaqësisë diplomatike të një organizate ndërkombëtare, për vitet 2009 dhe 2010; (iii) vlerësimin nëse, në analizën financiare të kryer nga Komisioni, duhen marrë në konsideratë vetëm kursimet nga të ardhurat e personit të lidhur me burim të deklaruar nga paga si gjyqtar për vitet 2005-2010, rezulton se Kolegjit, nga analiza paraprake e kryer, bazuar në këto shkaqe ankimi, i ka rezultuar se:

(i) Personi i lidhur me subjektin në vitin 2003 rezulton me një situatë financiare negative, në vlerën **-1.281.796 lekë** (trajtuar më sipër në burimet e ligjshme të krijimit të pasurisë *Apartament banimi* në Vlorë); dhe (ii) me një diferencë negative financiare, në vlerën negative **-171.493 lekë**, për të krijuar me burime të ligjshme shumën 1.500.000 lekë, përdorur për pagesën e pasurisë *Apartament banimi* në Tiranë, paguar në vitin 2011.

3.2 Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet ndaj analizës paraprake financiare në seancën gjyqësore të datës 9.6.2022, lidhur me këtë konkluzion të Kolegjit, përveç sa trajtuar në pikën 1.5, ka pretenduar rishikimin e të ardhurave të personit të lidhur për vitet 2009-2010, si dhe të kursimeve *cash* të këtij të fundit, për vitet 2006 dhe 2011.

3.3 Komisioneri Publik, pasi vlerësoi analizën paraprake financiare të kryer nga Kolegji, bazuar në shkaqet e ankimit, prapësimet e subjektit në seancën e datës 9.6.2022, dhe aktet e vëna në dispozicion gjatë kësaj seance, lidhur me këtë shkak ankimi, gjen të drejta pretendimet e subjektit mbi njohjen e të ardhurave të personit të lidhur për vitet 2009-2010, duke u reflektuar edhe në mundësinë e kursimit të personit të lidhur për të krijuar kursimet *cash* për këtë periudhë, dhe mbulimin me të ardhura të ligjshme të shumës prej 1.500.000 lekë, paguar në vitin 2011, për blerjen e pasurisë *Apartament banimi* në Tiranë.

3.3.1 Mbi pretendimin e subjektit për rishikimin dhe përfshirjen e kursimeve në *cash* të vitit 2006 të personit të lidhur, sikundër arsyetuar dhe më sipër, në trajtimin e burimeve të ligjshme të pasurisë *Apartament banimi* në Vlorë, në konsideratë të pretendimit mbi llogaritjen e kursimeve në shumën 600.000 lekë, nga analiza financiare rezulton një diferencë negative në mbulimin e kursimeve dhe shpenzimeve për këtë vit, në masën rreth **-99.000 lekë** (vlerë kjo e përfshirë në mungesën e burimeve të ligjshme për krijimin e pasurisë *Apartament banimi* në Vlorë).

3.3.2 Ndërkohë vlerësohet i pambështetur pretendimi i subjektit mbi kursimet *cash* të pretenduara nga personi i lidhur për vitin 2011, me burim nga shitja e automjetit me targa: ***, për sa kohë

⁸ (i) Kontratë premtim-shitje nr. *** rep., nr. *** kol., datë **.2.2011; (ii) Kontratë shitje nr. *** rep., nr. *** kol., datë **.10.2012.

shuma e përfituar nga shitja nuk rezulton e deklaruar në DV-2011, si shtim i likuiditeteve *cash* të vitit.

4. *Verifikimi i mundësisë financiare të personave të tjerë të lidhur (prindërit e subjektit), për t'i dhënë kësaj të fundit hua shumë prej 25.000 euro, në vitin 2011, duke rivlerësuar të gjitha burimet e deklaruar dhe të pretenduara prej subjektit të rivlerësimit*

4.1 Kolegji, bazuar në pretendimet e Komisionerit Publik, ka kryer analizën paraprake financiare të prindërve të subjektit, për periudhën 2005 - janar 2011, analizë nga e cila ka rezultuar se, deri në janar të vitit 2011, prindërit e subjektit të rivlerësimit duket se kanë qenë në pamundësi financiare për të justifikuar me të ardhura të ligjshme shumë e dhënë hua prej 25.000 euro, subjektit të rivlerësimit, për një diferencë negative prej – 21.027 euro.

4.2 Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet ndaj analizës paraprake financiare të Kolegjit, në seancën gjyqësore të datës 9.6.2022, ka pretenduar rishkimin e: (i) shpenzimeve të jetesës së prindërve, llogaritur në këtë analizë paraprake, në masën rreth trefish të shpenzimeve sipas standardit të përcaktuar nga ILDKPKI-ja; si dhe (ii) të ardhurat nga pensioni suplementar i babait ***.***.⁹

4.3 *Komisioneri Publik*, pasi vlerësoi analizën paraprake financiare të kryer nga Kolegji, bazuar në shkaqet e ankimit, prapësimet e subjektit në seancën e datës 9.6.2022 dhe aktet e vëna në dispozicion gjatë kësaj seance, lidhur me këtë shkak ankimi, duke i qëndruar të gjithë arsyetimit, bërë në ankimin e datës 14.4.2021, mbi periudhën që duhet marrë në analizë, 2005 – shkurt 2011, e gjen të drejtë pretendimin e subjektit mbi përlllogaritjen e shpenzimeve të jetesës së prindërve në përputhje me standardin e përdorur nga organet e rivlerësimit, gjatë këtij procesi.

4.3.1 Përveç sa më sipër, në vlerësimin e tij, Komisioneri Publik mban në konsideratë faktin se prindërit e subjektit të rivlerësimit kualifikohen si persona të tjerë të lidhur, për shkak të kësaj marrëdhënieje huaje, e cila rezulton e deklaruar si e tillë nga subjekti i rivlerësimit, si në deklaratën periodike të vitit përkatës, ashtu dhe në Deklaratën “Vetting”.

4.3.2 Për shkak të parashikimeve të ligjit nr. 84/2016, gjatë hetimit administrativ, në përgjigjet e pyetësorit datë 9.10.2019, subjekti ka deklaruar burimin e shumës së dhënë hua, në përmbushje të detyrimit të saj ligjor, për të provuar burimin e krijimit të pasurive të personave të tjerë të lidhur.

4.3.3 Nisur nga fakti se shuma prej 40.000 lekë në muaj, deklaruar dhënë prindërve në formë ndihme mujore nga znj. ***.***, në kuadër të një marrëdhënieje të posaçme familjare (*fëmijë-prind*), si dhe rrethanës kur është provuar mundësia financiare nga të ardhura të ligjshme e motrës së subjektit, për t'i ofruar ndihmë ekonomike prindërve (nga viti 1995 e në vijim), të cilat në vlerësimin e Komisionerit janë marrë në konsideratë në mbulimin e shpenzimeve të jetesës së vetë subjektit deri në vitin 2004, vlerësohet e provuar se prindërit e subjektit mbulojnë me burime të ligjshme huan në vlerën 25.000 euro.

⁹ Shkresë nr. *** prot., datë **.4.2022, e Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

5. Verifikimi i të drejtave të subjektit të rivlerësimit mbi automjetin tip Audi Q7, në pronësi të babait të personit të lidhur

5.1 Si rrjedhojë e kërimit për verifikimin e të drejtave të ushtruara nga subjekti mbi këtë automjet, nga analiza financiare e kryer nga Kolegji, mbi mundësinë financiare të prindërve të personit të lidhur, për periudhën 1994 deri në maj 2011, ka rezultuar në një diferencë negative prej - 4.993.395 lekë.

5.2 Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet ndaj analizës paraprake financiare në seancën gjyqësore të datës 9.6.2022, lidhur me verifikimin e të drejtave që ajo ka ushtruar mbi këtë automjet, ka pretenduar se: (i) fitimi i titullit të pronësisë së automjetit Audi Q7, nga z. ***.***, daton përpara lidhjes së martesës ligjore; (ii) kontrata e huapërdorjes me nr.*** rep., nr. *** kol., datë **.7.2011, e lidhur ndërmjet ish-bashkëshortit dhe babait të tij, daton përpara lidhjes së martesës ligjore dhe subjekti nuk i janë kaluar tagra përdorimi prej pronarit të mjetit dhe nuk e ka drejtuar asnjëherë këtë mjet dhe, si rrjedhim, bazuar edhe në jurisprudencën e Kolegjit, në kushte kur kjo pasuri është krijuar nga babai i ish-bashkëshortit, përpara lidhjes së martesës, subjekti nuk ka detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimeve të krijimit të kësaj pasurie.

5.3 Sa më lart qëndron pretendimi i subjektit të rivlerësimit mbi krijimin e kësaj pasurie nga babai i personit të lidhur, përpara lidhjes së martesës ligjore të subjektit me personin e lidhur. Në rrethanat konkrete të provuara gjendet, po ashtu, se subjekti nuk ka gëzuar të drejta mbi këtë mjet, të tilla që të mund të kualifikohen sipas përmbajtjes së dispozitës së pikës 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016.

I. Kërkimi përfundimtar i ankimit

Duke përfunduar për sa u parashtrua, subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e deklaramit të pasaktë dhe të pamjaftueshëm të pasurisë, referuar nenit D, të aneksit të Kushtetutës, nenit 33, pika 5, germa “b”, dhe nenit 61, pika 3, të ligjit nr. 84/2016, për një vlerë negativiteti prej **-5.432.452 lekë**, e në këto rrethana, Komisioneri Publik, bazuar në dispozitën e pikës 3 dhe 7, të nenit F, të aneksit të Kushtetutës, shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 66, të ligjit nr. 84/2016, kërkon nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit të vendosë:

- Ndryshimin e vendimit nr. 342, datë 2.2.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Elbana Lluri.

KOMISIONERI PUBLIK

Florian BALLHYSA